Interreg – IPA CBC
Italy - Albania - Montenegro
EUROPEAN UNION
COMPLICITIES

Emri dhe Adresa e Autoritetit Menaxhues:
Javnopreduzeće „Kulturnicentar“ Bar - JovanaTomasevica 57 - 85000 BAR - CRNA GORA – ME
Municipality of Lecce – Via Rubichi – 73100 Lecce - Italy
Consulting and Development Partners - Rr. Palokë Kurti 1 – 4001 Shkoder – Albania

Objekti i Thirrjes:

MURALE/STREET ART– THIRRJE E HAPUR PËR IDENTIFIKIMIN E ARTISTËVE QË DO TË PËRFSHIHEN NË PROJEKTIN EUROPIAN “COMPLICITIES”

Numri i Referencës: **ITALME 142**

Përshkrimi i Projektit:
Projekti “Arti Bashkohor për Modelimin e Periferive për Qytete të Banueshme-COMPLICITIES është propozuar nga një konsorcium i përbërë nga 3 partnerë (JP Kulturni Centar Tivar - Mali i Zi, Komuna e Leçes - Itali dhe CODE Partners - Shqipëri) dhe 1 partner i asociuar (Universiteti i Salentos - Itali). Gjetjet e shumta tregojnë se periferitë urbane kanë probleme të ngjashme, të lidhura me degradimin fizik dhe tensionet shoqërore. Në të njëjtën kohë, rrethinat shpesh ngjajnë me laboratorë në të cilët zhvillohen zgjidhjet inovative të qeverisjes urbane. COMPLICITIES konsideron zonat periferike si vende për zhvillim, që do të aktivizohen nga Industria Kulturore dhe Krijuese, si dhe ndërveprimi me kapitalin njerëzor.
COMPLICITIES synon të krijojë një model të përbashkët të transferueshëm për rigjenerimin e periferive bazuar në bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve lokale dhe institucioneve publike. Prandaj projekti ka nevojë për një dimension ndërkufitar për të zhvilluar një identitet të ri për zonat periferike, bazuar në rritjen e aseteve të tyre kulturore.
COMPLICITIES do të nxisë ndryshime pozitive: do të implementohet një kuadër i ri rregullator, duke promovuar pjesëmarrjen e CCIs –ve (Industria kulturore dhe krijuese) në zhvillimin e periferive. Përsosmëria krijuese e CCIs -ve do të aplikohet për zhvillimin bashkëpunues të zgjidhjeve inovative për rigjenerimin urban. Rezultatet kryesore do të jenë: miratimi i Strategjisë së Përbashkët për të nxitur rigjenerimin krijues urban dhe të Udhëzimeve të Komunitetit që veprojnë si plane veprimi lokale, duke ndihmuar autoritetet publike për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm urban; promovimin e periferive pilot si qendra krijuese për zhvillimin e projekteve krijuese nderkufitare, duke mbështetur banorët në zhvillimin e iniciativave krijuese.

Subjekti i thirrjes
Kjo thirrje synon të përzgjedhë 15 (pesëmbëdhjetë) Artistë të muraleve/street art që të përfshihen në Workshopet e ripërtëritjes krijuese te projektit "Complicities". Në mënyrë specifike, maksimumi 5 Artistë të muraleve/street art nga secili vend partner do të përzgjidhen:

- 5 (pesë) artistë italianë (nga rajoni i Pulias dhe Molise);
- 5 (pesë) artistë malazezë;
- 5 (pesë) artistë shqiptarë.

Workshopet e ripërteritjes krijuese të projektit do të organizohen ndërmjet muajve Maj dhe Shtator 2019 dhe do të zgjasin 10 ditë (max), që varet nga disponueshmëria e partnerëve të projektit për të organizuar aktivitetin. Vendet e përfshira në projekt do të jenë:
- **Qendra e qytetit të Tivarit, Mali i Zi;**
- **Zona Borgo Pace - Lecce, Itali;**
- **Zona Gjuhadol - Shkodër, Shqipëri**.

Workshopet e ripërtëritjes krijuese do të organizohen, strukturohen dhe realizohen me një marrëveshje të përbashkët dhe nën mbikëqyrjen e Drejtorit Artistik dhe partnerëve të projektit. Vendet ku aplikantët e përzgjedhur do të përfshihen do të përcaktohen nga Drejtori Artistik.

Aplikantët e kualifikuar dhe procedurat e aplikimit

Kjo thirrje u drejtohet artistëve të të gjitha gjinive, më të mëdhenj se mosha 18, që i përkasin një nga zonave pilot të projektit: Pulia, Molise, Shqipëria dhe Mali i Zi.
Aplikantët mund të paraqesin aplikimet e tyre me e-mail, duke bashkangjitur dokumentet e mëposhtme:
- **Letrën e aplikimit** në të cilën duhet të tregoni qartë 'Titulli i thirrjes', 'Numri i referencës', 'Emri, adresa, numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike të aplikantit'.
- **CV-ja personale** (e përditësuar), duke përfshirë eksperiencat e kaluara nga projekte të ngjashme.
- **Portofoli (CV) artistik** përfshirë maksimumi 5 përvoja / projekte të rëndësishme (link video / foto). Ju lutem dosjet nuk duhet të jenë më të mëdha se 1 Gb.
- **Kopja e Kartës së Identifikimit ose Pasaportës**.
- **Letër Motivimi** - maksimumi 2000 karaktere për të shpjeguar pse jeni aplikuesi më i përshtatshëm për t'u zgjedhur.

Aplikantët duhet të shkruajnë qartë në objekin e emailit:

- Titullin e thirrjes**: STREET ART – OPEN CALL FOR THE IDENTIFICATION OF ARTISTS TO BE INVOLVED TO THE EUROPEAN PROJECT "COMPLICITIES**
- Numri i referencës: **ITALME 142**

Aplikuesit duhet të dorëzojnë me e-mail në të dyja adresat e mëposhtme: artisticdirector.complicities@gmail.com dhe ipa.complicities@gmail.com

Aplikimet jo të plota nuk do të merren parasysh. Ju lutemi sigurohuni që keni dërguar të gjitha materialet e kërkuara.

Kushtet për aplikantët e përzgjedhur:
Artistët / aplikantët e përzgjedhur do tu jepen:

- Pagesa 100 euro në ditë (taksat e përfshira) për pjesëmarrjen e tyre në workshopet e ripërtëritjes krijuese dhe në rezidencë;
- Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, pagesat ditore dhe akomodimi për artistët që lëvizin jashtë vendit të tyre të banimit do të mbulohen tërësisht nga partnerët e projektit, në përputhje me projektin.
- Çdo partner përcakton vendin ku artistët / aplikuesit duhet të kryejnë aktivitete;

- Çdo partner në territorin e tij do të mbulojë shpenzimet e transportit lokal të cilat mund të jenë të nevojshme gjatë aktiviteteve;
- Lehtësirat dhe materialet e nevojshme për aktivitetet do të mbulohen nga partneri sipas buxhetit të projektit.

Afati i fundit për dorëzim:

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është 31 mars 2019, ora 12:00. Të gjitha aplikimet pas këtij afati do të refuzohen automatikisht.

Procedura e përzgjedhjes

Aplikuesit do të vlerësohen dhe përzgjidhen nga një Komitet i emëruar, i përbërë nga përfaqësuesi i çdo partneri të projektit dhe Drejtori Artistik.
Aplikantët do të përzgjidhen në bazë të kurrikulës së tyre personale dhe artistike, të letrës së tyre të motivimit të bashkangjitur kërkesës, sipas diagrames së rezultateve në vijim (max: 10 pikë):

Criteria	Points
Curriculum personal	max. 2
Curriculum artistik /portfol	max. 4
Letër Motivimi	max. 2
Njohuri të gjuhes angleze	max. 2
Total i pikëve	**max. 10**

Rrezultati minimal mbi bazën e të cilit do të përzgjidhen është 5 pikë. Komisioni i përzgjedhjes rezervon të drejtën të kërkojë dokumentet origjinale që provojnë të dhënat dhe informacionin e përfshirë në formularin e aplikimit, si dhe pezullon aplikimin deri në afatet kohore të dhëna aplikantëve për të siguruar dokumentacionin origjinal. Nëse ai nuk i sjell ato brenda kësaj periudhe, do të përjashtohet nga procedura. Pjesëmarrja në procesin e përzgjedhjes nënkupton pranimin e plotë të të dhënave të përfshira në këtë thirrje.
Përveç kësaj, të gjithë aplikantet e përzgjedhur u kërkohet të lëshojnë një deklaratë të detyrueshme për përdorimin e produkteve përfundimtare artistike, të realizuara gjatë workshopeve.

Për shkak të një numri të madh të aplikimeve që do të marrim, vetëm aplikuesit e përfshirë në listën e shkurtër do të kontaktohen dhe do informohen me e-mail dhe eventualisht do të ftohen për një intervistë / intervistë skype.

Mbrojtja e të dhënave personale

Të dhënat do të përpunohen në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë të Bashkimit Europian.

Kontakti dhe Informacioni

Për detaje dhe sqarime rreth kësaj thirrje, kontakto në email ipa.complicities@gmail.com duke shkruar ne subjekt të emailit: STREET ART – Information about the OPEN CALL FOR THE IDENTIFICATION OF ARTIST TO BE INVOLVED TO THE EUROPEAN PROJECT "COMPLICITIES".